

Bazuar në Urdhërin nr. 5352/1 Prot, datë 28/07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bën shpalljen e vendit të lirë të punës për pozicionin:

Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Dibër

Kandidati konkurues

- Duhet të zotërojë diplomë të Arsimit të lartë në Shkenca ekonomike, Juridike, Administrim publik, Shkenca sociale;
- Përparësi kanë kandidatët me “Master Shkencor” dhe ata që kanë të paktën 7 vjet eksperiencë në fushën e administratës publike dhe/ose në një nivel të lartë menaxhimi në institucione private;
- Të ketë eksperiencë pune mbi 2 vjet në nivel përgjegjës sektori brenda administratës së sigurimeve shoqërore, si dhe/ose jo më pak se 2 vjet në administratë publike/shërbim civil të një kategorie të barazvlefshme me kategorinë e drejtorit të drejtorisë apo me kategorinë e përgjegjësit të sektorit, apo në sektorin privat në nivel të lartë menaxhimi, në nivel përgjegjësi apo drejtuesi.

Kandidati që konkuron duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk është shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista me gojë.

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohuritë në fushën e sigurimeve shoqërore (statusi i ISSH-së, Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar);
- Njohuri të Rregulloreve të përfitimeve, kontributeve, financiare, personelit dhe për sistemin e informacionit të ISSH;
- Njohuri të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat";
- Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë;
- Njohuri të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Njohuri të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Njohuri të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Në vlerësimin e kandidatëve, përfshihen:

- a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- b) intervista me gojë, ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkurohet.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, deri në 40 pikë;
- b) për intervistën me gojë, deri në 60 pikë;

Kandidati konkurues kualifikohet nëse në total ka fituar mbi 70 pikë, nga 100 pikë të mundshme, gjatë fazës së vlerësimit.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat me postë, në zyrën e protokollit të ISSH-së, si më poshtë:

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin janë të interesuar;
- Një kopje të jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Raport të aftësisë për punë;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje të Kartës së identitetit.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave me postë, duhet të bëhet brenda datës 08.08.2022, pranë zyrës së prokoll/sekretarisë në ISSH.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart.

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e ISSH-së në datën **11.08.2022, ora 10.00.**